

VENDIM
Nr. 199, datë 10.4.2019

PËR PËRCAKTIMIN E KRYETARIT DHE EMËRIMIN E ANËTARËVE,
PËRFAQËSUES TË PUSHTETIT QENDROR, NË KËSHILLIN DREJTUES TË
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT

(Ndryshuar me vendimin nr. 77, datë 10.2.2021)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e zëvendëskryeministrit, z. Erion Braçe, kryetar të këshillit drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

2. Emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si më poshtë vijon:

- znj. Elva Margariti, ministër i Kulturës;
- znj. *Adela Xhemali*, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë;
- znj. Ornela Çuçi, zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit;
- z. *Hantim Bonati*, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë.

3. Vendimi nr. 982, datë 25.10.2013, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kryetarit dhe emërimin e anëtarëve, përfaqësues të pushtetit qendror, në këshillin drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe